"6. Tabela elektronike për mbajtjen e kohës së ndeshjeve;

7. Çanta sportive;

8. Kronometra për stërvitje;

9. Kupa sportive;

10. Medalje sportive."

11. Në kapitullin XIV "Federata Shqiptare e Qitjes", pas pikës 7 shtohen pikat, si më poshtë vijon:

"8. Aksesorë dhe pjesë ndërrimi të armëve;

9. Mjete optike (stereogypa) për shkimin e goditjeve;

10. Aparate elektrike për ndërrimin e shenjave të qitjes;

11. Shenja qitjeje prej letre."

12. Në kapitullin XVIII "Federata Shqiptare e Volejbollit", pas pikës 5 shtohen pikat, si më poshtë vijon:

"6. Shtylla volejboli dhe beach-volej, së bashku me mbrojtëset e tyre;

7. Kullë për gjyqtarët;

8. Rrjeta volejboli dhe beach-volley, së bashku me antena;

9. Shtresë plastike me tartan ose me ger-floër për fushën e volejbollit;

10. Flamur për gjyqtarët anësorë;

11. Bilbila për gjyqtarët;

12. Matëse presioni për topat;

13. Tabela me numra nga 1-22, për ndërrimin e lojtarëve;
 14. Mbajtëse topash (kosha me rrota);
 15. Çanta për mbajtjen e topave;
 16. Uniforma sportive për gjyqtarët (Bluza, pantallona, atlete, çanta);
 17. Uniforma sportive për lojtarët (bluza, mbathje, tuta sportive, xhupa sportive, gjunjëza, këpucë, atlete, çanta sportive);
 18. Pajisje të ndryshme për përgatitjen fizike;
 19. Kompjuter për mbajtjen e statistikave;
 20. Literaturë, videokaseta dhe CD në ndihmë të stërvitjes së volejbillit;
 21. Banera publicitare me foto nga volejboli dhe beach-voley;
 22. Tabelë elektronike për mbajtjen e pikëve gjatë garave;
 23. Sinjalizues për pushimet;
 24. Numëror tryeze për mbajtjen e pikëve."
13. Në kapitullin XXI "Federata Shqiptare e Xhudos", pas pikës 3 shtohen pikat, si më poshtë vijon:
- "4. Peshore elektronike;
 5. Tuta komplet (bluzë dhe pantallona);
 6. Këpucë sportive;
 7. Çanta sportive;
 8. Kronometra për stërvitje;
 9. Kupa sportive;
 10. Medalje sportive."
14. Pas kapitullit XXI shtohen kapitujt, si më poshtë vijon:
- "Kapitulli XXII "Federata Shqiptare e Tenisit":
1. Raketa për të rritur;

2. Raketa, për fëmijë, të madhësive të ndryshme;
3. Topa të gjelbër për stërvitje;
4. Topa të gjelbër për gara;
5. Topa të butë për stërvitje;
6. Topa me kërcim mesatar për stërvitje;
7. Fije për lidhjen e raketave;
8. Makina për lidhjen e raketave;
9. Minirrjeta tenisi;
10. Shirita për lidhjen e bishtit të raketës;
11. Çanta tenisi.

Kapitulli XXIII "Federata Shqiptare e Shahut":

1. Pajisje elektronike të fushës së shahut;
2. Kompjuter për mësimin e shahut;
3. Tabela elektronike demonstrative;
4. Ora elektronike tryeze, specifike për shahun;
5. Ora elektronike muri për shahun;
7. Fusha dhe gurë shahu (komplete);
8. Disketa, CD me programe për lojën e shahut;
9. Literaturë informative, enciklopedi, libra, revista për shahun etj.;
10. Tabela demonstrative muri, të thjeshta.

Kapitulli XXIV "Federata Shqiptare e Boëling":

1. Pjesë këmbimi mekanike, elektrike e elektronike;
2. Solucione për pastrimin dhe mirëmbajtjen e pistave të boëling-ut;
3. Topa boëling-u;

4. Këpucë për sportistët (që përdoren gjatë linjës);

5. Birila për lojën e boëlingut.

Kapitulli XXV "Federata Shqiptare e Bilardos":

1. Tryeza bilardoje (të tipave dhe të përmasave të ndryshme, Pool Snooker, Carom, Birila);

2. Steka të tipave të ndryshme;

3. Aksesorë për tryezat e bilardos (llambadarë, gurë, bilardo, copë për veshje tryezash bilardoje, mbajtëse stekash, sahatë elektronikë, sahatë mbajtës të gurëve, gropa, xhepa, trekëndësha, stanok, kupa etj.

Kapitulli XXVI "Federata Shqiptare e Bodybiling":

1. Boshte shtange dhe pesha të ndryshme;

2. Gira;

3. Makineri (biçikleta statike, makina vrapimi, makina të ndryshme për stërvitjen e grupmuskujve).

Kapitulli XXVII "Komiteti Olimpik Shqiptar":

1. Materiale promocionale për ekipin olimpik shqiptar;

(Stema, emblema, mbajtëse çelësash, veshje sportive (bluzë tute, tuta, kapele, këpucë sportive), manuale;

2. Veshje përfaqësimi zyrtar (kostume për femra dhe meshkuj, këmisha, këpucë);

3. Aksesorë të ndryshëm për delegacionet sportive zyrtare (flamuj, postera, videofilma, mbajtëse të flakës olimpike, pishtar).".

2006/3.2

VENDIM

Nr.895, datë 21.12.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.306, DATË 24.5.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË MATERIALEVE DHE TË PAJISJEVE SPORTIVE, QË DO TË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMET DOGANORE DHE PROCEDURAT E PËRJASHTIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 5 e 6 të nenit 7 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.306, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që do të përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar".

2. Në pikën 1 pas fjalëve "... detyrimet doganore ..." shtohen "... dhe tatimi mbi vlerën e shtuar..." .

3. Në aneksin 1 bashkëlidhur vendimit bëhen shtesat sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

ANEKS 1

1. Pas pikës 32 të kapitullit VII "FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT", të shtohen pikat si më poshtë:

"33. Sistem komunikimi për arbitrat;

34. Fëshfëshe shiu;

35. Xhupa;

36. Tapet sintetik për fusha dhe aksesoret për instalimin e tij;

37. Parket për fusha dhe aksesoret për instalimin e tij;

38. Makineri mirëmbajtjeje për tapet sintetik futsali;

39. Makineri mirëmbajtjeje për parket futsali."

2. Pas pikës 11 të kapitullit XIV "FEDERATA SHQIPTARE E QITJES", të shtohen pikat si më poshtë:

"12. Pajisje për hedhjen e pjatelave në qitjen me pjatel;

13. Veshje speciale për qitjen me pjatel (jelekë, doreza, këpucë, kapele, pantallona, çanta);

14. Fishekë për qitjen me pjatel;

15. Pjatela për qitjen me pjatel."

3. Pas pikës 4 të kapitullit XIX "FEDERATA SHQIPTARE E SKIVE", të shtohen pikat si më poshtë:

"5. Makinë për prodhim bore "Snougan" (topa bore);

6. Makinë për shtypjen e borës dhe përgatitjen e pistës (Batipista);

7. Motor bore transporti dhe emergjence, "Snouxhet";

8. Mikrobuz transporti për bazë materiale" (copë 1);

9. Pajisje mekanike e rregullimit, kontrollit dhe kolaudimit të skive;

10. Tapet bari plastik për rrëshqitje në kushte verore;

11. Teleferik për ngjitjen e skiatorëve në pistë (copë 1).".

12. 4. Pas kapitullit XXVII, të shtohen kapitujt, si më poshtë:

13. "XXVIII. FEDERATA SHQIPTARE E GOLFIT", me këtë listë materialesh:

"1. Çanta golfi;

2. Shkopinj golfi për të gjitha moshat;

3. Topa golfi;

4. Fanella golfi;

5. Pantallona golfi;

6. Xhaketa golfi;

7. Këpucë golfi për të gjitha moshat;

8. Simulator golfi;

9. Sete golfi të kompletuar (çantë, shkopinj, topa, peshqirë, kapele, doreza golfi);

10. Pajisje për mirëmbajtje fushe golfi.".

XXIX. FEDERATA SHQIPTARE E RAFTING", me këtë listë materialesh:

"1. Gomone;

2. Kanoë;

3. Kayak;

4. Kataraft;

5. Lopata;

6. Skafandra;

7. Veshje rafting;

8. Xhup uji;

9. Çorape;

10. Këpucë rafting;

11. Kostum sportiv;

12. Bluzë sportive;

13. Xhup sportiv;
14. Kapele;
15. Atlete;
16. Çanta sportive;
17. Aksesorë (litar, bilbil);
18. Prozhektor;
19. Kamerë filmimi antiujë (copë 1);
20. Aparat fotografik antiujë" (copë 1).".

"XXX. FEDERATA SHQIPTARE E AERONAUTIKËS", me këtë listë materialesh:

- "1. Parashuta;
2. Instrumente variometër;
3. Instrumente gps;
4. Sedilje parashutë;
5. Parashuta rezervë;
6. Veshje pilotësh;
7. Kaska;
8. Avionë të vegjël ultralight;
9. Parashuta për ngritje nga toka me tërheqje;
10. Pajisje vericel për ngritje velash nga toka;
11. Pajisje aerodelizmi fluturuese;
12. Paramotorë;
13. Erika paramotorësh.".

"XXXI. FEDERATA SHQIPTARE E LUNDRIMIT ME VELA", me këtë listë materialesh:

- "1. Barka dhe mjete lundrimi me vela;
2. Barka dhe mjete lundrimi me motor (copë 1);
3. Barka dhe mjete lundrimi me rrema;
4. Kanoë;
5. Kayak;

6. Pajisje për transportimin e barkave në tokë dhe në plazh (karele);
7. Pajisje të bregëzimit të mjeteve dhe barkave;
8. Pajisje të ndriçimit në bord, breg, ujë dhe nën ujë;
9. Veshje sportive;
10. Kayak."

"XXXII. FEDERATA SHQIPTARE SPORT PËR TË GJITHË", me këtë listë materialesh:

- "1. Veshje sportive;
2. Shirita kufizues;
3. Materiale dekorative (fjongo, topa, tullumbace).".

2006/3.3

VENDIM

Nr. 704, datë 26.8.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 306, DATË 24.5.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË MATERIALEVE DHE TË PAJISJEVE SPORTIVE, QË DO TË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMET DOGANORE DHE TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 5 e 6, të nenit 7, të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005, "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 306, datë 24.5.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim emërtesa "Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve" zëvendësohet me "Ministria përgjegjëse për sportet".
2. Në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:
 - a) Titulli i aneksit ndryshohet dhe zëvendësohet me "Lista e materialeve dhe e pajisjeve sportive, që përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar".
 - b) Kudo ku përmendet emërtesa "Federata shqiptare" shtohen fjalët "... dhe klubet sportive shqiptare ...".
 - c) Në fund të çdo kapitulli shtohet sipas rendit numerik respektiv togfjalëshi "Autobus (copë 1)".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

2006/4

VENDIM

Nr. 305, datë 24.5.2006

PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË LARTË SPORTIV DHE MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË SPORTISTËVE, QË ARRIJNË KËTO NIVELE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 26, të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 "Për sportin", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për të rritur, në sportet individuale, në përbërje të ekipit kombëtar dhe të ekipeve kombëtare të sporteve kolektive, futboll, basketboll, volejball, atletikë, gjimnastikë, mundje, peshëngritje, boks dhe qitje, të jenë rezultatet e arritura në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare, si më poshtë vijon:

- a) Sportisti, i cili thyen rekord olimpik;
- b) Sportisti, i cili thyen rekord botëror;
- c) Sportisti, i cili thyen rekord evropian;
- ç) Vendi i parë deri në vendin e tetë në lojërat olimpike;
- d) Vendi i parë deri në vendin e gjashtë në kampionate botërore;
- dh) Vendi i parë deri në vendin e tretë në kampionate evropiane;
- e) Vendi i parë në lojërat mesdhetare.

Klasifikimi i ekipeve në sportet individuale nuk merret parasysh në kategorizimin e mësipërm.

1.1. Kategoria e të rinjve, që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1 të vendimit, shpërblehet në masën 25 për qind të vlerës së përcaktuar për të rriturit, sipas tarifave të tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit.⁸⁹

2. Sportistët, që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të shpërblehen sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

⁸⁹(Ndryshuar me VKM, Nr.598, dt. 31.08.2006, botuar në FLZ Nr.99, datë 22.09.2006)

3. Trajnerët e sportistëve të nivelit të lartë të shpërblehen në masën 30 për qind, mbështetur në kategorizimin dhe vlerat e përcaktuara në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Sportistët e përcaktuar në pikën 1, përfitojnë këto të drejta.

- Të drejtën e studimit në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sportit, pa konkurrim.

- Kryerjen e studimeve akademike, sipas një plani individual, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës.

- Të drejtën e përfitimit të pensionit të posaçëm shtetëror, me arritjen e moshës së pensionit, sipas procedurave të parashikuara në vendimin nr.429, datë 12.9.2002 të Këshillit të Ministrave "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore".

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Tabela e parë

Lojëra mesdhetare Vendi i parë 3 000 000 lekë

Kampionat evropian Vendi i parë 5 000 000 lekë

Kampionat evropian Vendi i dytë 3 000 000 lekë

Kampionat evropian Vendi i tretë 2 000 000 lekë

Kampionat botëror Vendi i parë 10 000 000 lekë

Kampionat botëror Vendi i dytë 8 000 000 lekë

Kampionat botëror Vendi i tretë 6 000 000 lekë

Kampionat botëror Vendi i katërt 4 000 000 lekë

Kampionat botëror Vendi i pestë 3 000 000 lekë

Kampionat botëror Vendi i gjashtë 2 000 000 lekë

Lojërat olimpike Vendi i parë 15 000 000 lekë

Lojërat olimpike Vendi i dytë 10 000 000 lekë

Lojërat olimpike Vendi i tretë 7 000 000 lekë

Lojërat olimpike Vendi i katërt 4 000 000 lekë

Lojërat olimpike Vendi i pestë 3 000 000 lekë

Lojërat olimpike Vendi i gjashtë 2 000 000 lekë

Lojërat olimpike Vendi i shtatë 1 000 000 lekë

Lojërat olimpike Vendi i tetë 500 000 lekë

2006/4.1

VENDIM

Nr. 598, datë 31.8.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.305, DATË 24.5.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË LARTË SPORTIV DHE MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË SPORTISTËVE, QË ARRIJNË KËTO NIVELE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 "Për sportin" dhe të neneve 124 e 125 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr. 305, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Kategoria e të rinjve, që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1 të vendimit, shpërblehet në masën 25 për qind të vlerës së përcaktuar për të rriturit, sipas tarifave të tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

2008/1

VENDIM

Nr.1718, datë 24.12.2008

PËR PROCEDURAT E TRANSFORMIMIT TË KLUBEVE SPORTIVE NË SHOQËRI AKSIONARE DHE PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË KAPITALIT THEMELTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Klubet sportive, që do të transferohen në shoqëri aksionare, do të funksionojnë në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

2. Procedura e transformimit të tyre fillon me daljen e urdhrat të titullarit të institucionit, në varësi administrative të të cilit është klubi sportiv.

3. Përcaktimi i kapitalit themeltar të këtyre shoqërive, që do të krijohen nga transformimi i klubit sportiv, bëhet në bazë të:

a) bilancit të vitit ushtrimor financiar, pararendës;

b) emrit të klubit, të logos së tij dhe të vlerës, që do të jetë deri në masën 30 për qind të vlerës së kapitalit themeltar. Kjo vlerë përcaktohet nga viti i krijimit të klubit, trofetë e arritura, pjesëmarrja në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Përcaktimi i kapitalit të këtyre shoqërive bëhet nga një komision i ngritur pranë çdo klubi, me urdhër të titullarit të tij.

5. Klubi sportiv, i transformuar në shoqëri aksionare, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ish-klubit sportiv, në bazë të bilancit financiar, në çastin e transformimit.

6. Vlera kontabël e mbetur e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara aktuale rivlerësohet, sipas kriterëve të caktuara në vendimin nr.794, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes".

7. Elementet e pasurisë, pa vlerë përdorimi ose të zhvlerësuar, të trajtohen për t'u nxjerrë jashtë përdorimit ose për ulje vlere, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi. Ulja e vlerës të kryhet nga komisioni i vlerësimit, me pjesëmarrjen e dy a më shumë ekspertëve të fushave përkatëse, në varësi nga natyra e elementeve të pasurisë.

8. Bilanci i çeljes së shoqërisë aksionare, të krijuar nga transformimi i klubit sportiv është bilanci i reformuar. Ky bilanc verifikohet edhe vërtetohet nga një ekspert kontabël, i autorizuar, i emëruar nga organi, që ka në varësi këtë klub.

9. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të nxjerrin udhëzimin përkatës për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit të vlerësimit e të ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe për përcaktimin e mënyrës së vlerësimit të aseteve, logos dhe kapitalit.

10. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

2008/2

VENDIM

Nr.1720, datë 29.10.2008

PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË LARTË SPORTIV, PËR MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË SPORTISTËVE, QË I ARRIJNË KËTO NIVELE, SI DHE PËR PËRFITIMIN E TRAJTIMIT PËR PËRGATITJEN SPORTIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 26 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 "Për

sportin", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv dhe mënyra e shpërblimit

Sportistët e nivelit të lartë klasifikohen sipas rezultateve të larta sportive, të arritura në veprimtaritë ndërkombëtare dhe kombëtare.

1. Veprimtaritë ndërkombëtare:

1.1. Kriteria për përcaktimin e nivelit të lartë sportiv, për të rritur, në sportet individuale, në përbërje të ekipit kombëtar dhe të ekipeve kombëtare të sporteve kolektive, si futboll, basketboll, volejball, atletikë, gjimnastikë, not, peshëngritje, boks, mundje **xhudo**⁹⁰ e qitje, të jenë rezultatet e arritura në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare, sipas klasifikimeve përfundimtare, të përcaktuara në rregulloret ndërkombëtare të këtyre sporteve, si më poshtë vijon:

a) Sportisti i cili thyen rekord olimpik;

b) Sportisti i cili thyen rekord botëror;

c) Sportisti i cili thyen rekord evropian;

ç) Vendi i parë deri në vendin e gjashtë, në Lojërat Olimpike;

d) Vendi i parë deri në vendin e pestë, në kampionate botërore;⁹¹

dh) Vendi i parë deri në vendin e tretë, në kampionatin evropian;

e) Vendi i parë në Lojërat Mesdhetare.

Klasifikimi i ekipeve në sportet individuale nuk merret parasysh në kategorizimin e mësipërm.

1.2. Sportistët, që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1.1. të këtij kreu, të shpërblehen sipas tabelës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

1.3. Kategoria e të rinjve, që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1.1. të këtij kreu, të shpërblehen në masën 25 për qind të vlerës së përcaktuar për të rriturit, sipas tabelës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

1.4. Trajnerët e sportistëve të nivelit të lartë shpërblehen në masën 30 për qind, të vlerës së përcaktuar për sportistët fitues, sipas kategorizimeve të vlerave, dhënë në tabelën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

1.5. Sportistët e përcaktuar në pikën 1.1. të këtij kreu, përfitojnë të drejtën e studimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës, pa konkurrim, dhe të drejtën e kryerjes së studimeve akademike, sipas një plani individual, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.⁹²

1.6. Klasifikimi i ekipeve si dhe shuma përfituese, në sportet kolektive, është përcaktuar në tabelën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nga kjo shumë përcaktohet shpërblimi i sportistëve në sportet kolektive, i cili është individual dhe bazohet në kontributin e secilit.

⁹⁰ (Ndryshuar me VKM, Nr.214, dt. 31.03.2010, botuar në FLZ Nr.44, datë 20.04.2010)

⁹¹ (Ndryshuar me VKM, Nr.335, dt. 02.03.2011, botuar në FLZ Nr.75, datë 13.06.2011)

⁹² (Ndryshuar me VKM, Nr.875, dt. 03.11.2010, botuar në FLZ Nr.161, datë 06.12.2010)

1.7. Këshilli Kombëtar i Sportit përcakton masën e shpërblimit, për fituesit e garave ndërkombëtare, bazuar në kriteret e përcaktimit të nivelit të rezultateve dhe të pjesëmarrjes së tyre.

1.8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për pikat 1.1 e 1.6 të këtij kreu, përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.⁹³

1.9. Për veprimtaritë e tjera të rëndësishme ndërkombëtare, shpërblimi të përballohet nga buxheti i vitit, fondi për sportin, në dispozicion të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të federatave sportive, përkatëse, deri 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

2. Veprimtaritë kombëtare

2.1. Kriteret për përcaktimin e nivelit të lartë sportiv në veprimtaritë kombëtare janë rezultatet e arritura në këto veprimtari, si më poshtë vijon:

a) Sportisti, i cili thyen rekordin kombëtar;

b) Vendi i parë në kampionatin kombëtar.

2.2. Shpërblimi, sipas masës së përcaktuar në tabelën III, që i bashkëlidhet këtij vendimi, jepet dhe mbulohet nga federatat përkatëse.

II. Përfitimi i trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë

1. Sportistët pjesëmarrës në veprimtaritë kombëtare të kategorisë së parë dhe superiore, për përgatitjen e tyre përfitojnë trajtim ushqimor dhe mjekësor.

2. Trajtimi ushqimor jepet në para ose në natyrë. Trajtimi ushqimor vjetor është deri 2000 (dy mijë) lekë në ditë, për 25 ditë në muaj. Trajtimi mjekësor për medikamente dhe rehabilitim është deri 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj.

3. Trajtimi ushqimor dhe mjekësor, mbulohet, plotësisht ose pjesërisht, nga klubet sportive, me fondet e pushtetit vendor a të ardhura të tjera, të ligjshme.

4. Për sportistët e përcaktuar në pikën 1.1., të kreut I, federatat sportive kanë të drejtë të kompensojnë trajtimin ushqimor dhe mjekësor, maksimal, nëse klubi përkatës nuk mund ta mbulojë atë.

5. Federatat dhe klubet kanë të drejtë të grumbullojnë ekipet e tyre përfaqësuese për veprimtari të rëndësishme ndërkombëtare. Vlera ditore për akomodim dhe ushqim të jetë deri në 6 000 (gjashtë mijë) lekë në ditë, deri 50 ditë në vit.

6. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi nr.305, datë 24.5.2006 i Këshillit të Ministrave "Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv dhe mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që arrijnë këto nivele", të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

TABELA I

KLASIFIKIMI NË RENDITJEN INDIVIDUALE, SPORTET INDIVIDUALE

⁹³ (Ndryshuar me VKM, Nr.214, dt. 31.03.2010, botuar në FLZ Nr.44, datë 20.04.2010)

DHE SHPËRBLIMET

Tabela 1

Rekord Olimpik 15 000 000 lekë

Rekord Botëror 15 000 000 lekë

Rekord Evropian 8 000 000 lekë

Lojërat Olimpike Vendi i parë 10 000 000 lekë

Lojërat Olimpike Vendi i dytë 7 000 000 lekë

Lojërat Olimpike Vendi i tretë 5 000 000 lekë

Lojërat Olimpike Vendi i katërt 3 000 000 lekë

Lojërat Olimpike Vendi i pestë 2 000 000 lekë

Lojërat Olimpike Vendi i gjashtë 1 000 000 lekë

Kampionati Botëror Vendi i parë 10 000 000 lekë

Kampionati Botëror Vendi i dytë 6 000 000 lekë

Kampionati Botëror Vendi i tretë 4 000 000 lekë

Kampionati Botëror Vendi i katërt 2 000 000 lekë

Kampionati Botëror Vendi i pestë 1 000 000 lekë

Kampionati Evropian Vendi i parë 4 000 000 lekë

Kampionati Evropian Vendi i dytë 2 000 000 lekë

Kampionati Evropian Vendi i tretë 1 000 000 lekë

Lojërat Mesdhetare Vendi i parë 1 000 000 lekë⁹⁴

TABELA II

KLASIFIKIMI NË RENDITJEN EKIPORE DHE SHPËRBLIMET

Lojërat olimpike Vendi i parë deri i treti Deri 20 000 000 lekë

Kampionat botëror Vendi i parë deri i treti Deri 15 000 000 lekë

Kampionat evropian Vendi i parë deri i treti Deri 7 000 000 lekë

Kampionat

Lojërat mesdhetare Vendi i parë Deri 2 000 000 lekë

⁹⁴ (Ndryshuar me VKM, Nr.335, dt. 02.03.2011, botuar në FLZ Nr.75, datë 13.06.2011)

TABELA III

SHPËRBLIMET PËR FITUESIT NË VEPRIMTARITË KOMBËTARE

Rekord kombëtar Deri 30 000 lekë

Kampion kombëtar Vendi i parë Deri 20 000 lekë

Ekipi kampion kombëtar në lojëra Vendi i parë

Vendi i dytë dhe i tretë Deri 200 000 lekë

Deri 100 000 lekë

2008/2.1

VENDIM

Nr.214, datë 31.3.2010

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1720, DATË 29.10.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË LARTË SPORTIV, PËR MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË SPORTISTËVE, QË I ARRIJNË KËTO NIVELE, SI DHE PËR PËRFITIMIN E TRAJTIMIT PËR PËRGATITJEN SPORTIVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 26 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun I të vendimit nr.1720, datë 29.10.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1.1, pas fjalës "...mundje...", shtohet fjala "...xhudo...".

2. Pika 1.8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1.8 Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për pikat 1.1 e 1.6 të këtij kreu, përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

2008/2.2

VENDIM

Nr.875, datë 03.11.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1720, DATË 29.10.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË LARTË SPORTIV, PËR MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË SPORTISTËVE, QË I ARRIJNË KËTO NIVELE, SI DHE PËR PËRFITIMIN E TRAJTIMIT PËR PËRGATITJEN SPORTIVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 "Për sportin", të ndryshuar, dhe të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1.5 e vendimit nr.1720, datë 29.10.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1.5 Sportistët e përcaktuar në pikën 1.1. të këtij kreu, përfitojnë të drejtën e studimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës, pa konkurrim, dhe të drejtën e kryerjes së studimeve akademike, sipas një plani individual, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës."

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

2008/2.3

VENDIM

Nr.335, datë 2.3.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1720, DATË 29.10.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË LARTË SPORTIV, PËR MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË SPORTISTËVE QË I ARRIJNË KËTO NIVELE, SI DHE PËR PËRFITIMIN E TRAJTIMIT PËR PËRGATITJEN SPORTIVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1720, datë 29.10.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronjat "ç" dhe "d", të nënndarjes 1.1 të pikës 1, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"ç) Vendi i parë deri në vendin e gjashtë, në Lojërat Olimpike; d) Vendi i parë deri në vendin e pestë, në kampionate botërore."

b) Tabela 1 bashkëlidhur vendimit zëvendësohet me tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Tabela 1

KLASIFIKIMI NË RENDITJEN INDIVIDUALE, SPORTET INDIVIDUALE DHE SHPËRBLIMET

Rekord Olimpik 15 000 000 lekë

Rekord Botëror 15 000 000 lekë

Rekord Evropian 8 000 000 lekë

Lojërat Olimpike Vendi i parë 10 000 000 lekë

Lojërat Olimpike Vendi i dytë 7 000 000 lekë

Lojërat Olimpike Vendi i tretë 5 000 000 lekë

Lojërat Olimpike Vendi i katërt 3 000 000 lekë

Lojërat Olimpike Vendi i pestë 2 000 000 lekë

Lojërat Olimpike Vendi i gjashtë 1 000 000 lekë

Kampionati Botëror Vendi i parë 10 000 000 lekë

Kampionati Botëror Vendi i dytë 6 000 000 lekë

Kampionati Botëror Vendi i tretë 4 000 000 lekë

Kampionati Botëror Vendi i katërt 2 000 000 lekë

Kampionati Botëror Vendi i pestë 1 000 000 lekë

Kampionati Evropian Vendi i parë 4 000 000 lekë

Kampionati Evropian Vendi i dytë 2 000 000 lekë

Kampionati Evropian Vendi i tretë 1 000 000 lekë

Lojërat Mesdhetare Vendi i parë 1 000 000 lekë

2014/1

VENDIM

Nr. 401, datë 18.6.2014

PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË KOMISIONIT KOMBËTAR KUNDËR DHUNËS NË SPORT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 50, të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005, "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni Kombëtar kundër Dhunës në Sport të kryesohet nga zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit dhe në përbërje të ketë 5 (pesë) anëtarë dhe 1 (një) koordinator/sekretar, si më poshtë vijon:

- Drejtorin e Sporteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit anëtar;

- Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit anëtar;

- Presidentin e Komitetit Olimpik Shqiptar anëtar;

- Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës

Shqiptare të Futbollit anëtar;

- Një gazetar sportiv anëtar;

- Një specialist në Drejtorinë e Sportit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit koordinator/sekretar.

2. Komisioni Kombëtar kundër Dhunës në Sport thirret, si rregull, nga zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, jo më shumë se 4 (katër) herë në vit, pas njoftimit të bërë nga sekretari. Sekretari i Komisionit përgatit materialet që do të shqyrtohen dhe ua vë në dispozicion anëtarëve të Komisionit, 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes. Komisioni i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm jo më pak se pesë veta, në të kundërt, ajo bëhet jo më vonë se dy javë nga data e njoftimit të ri.

3. Anëtarët e Komisionit Kombëtar kundër Dhunës në Sport përfitojnë, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, një shpërblim prej 5 000 (pesë mijë) lekësh. Pagesat për shpërblimet të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ("Programi i sportit").

4. Vendimi nr. 18, datë 13.1.2006, i Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të Komisionit Kombëtar kundër Dhunës në Sport", shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe të gjitha institucionet, përfaqësuesit e të cilave janë përcaktuar në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

2014/2

VENDIM

Nr. 437, datë 2.7.2014

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES STRUKTURORE E TË SHPËRBLIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005, "Për sportin", të ndryshuar, dhe të vendimit nr.843, datë 27.9.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e përbërjes strukturore të Këshillit Kombëtar të Sportit, i cili kryesohet nga zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit dhe ka në përbërje 14 (katërmëdhjetë) anëtarë dhe 1 (një) sekretar, si më poshtë vijon:

- a) Drejtorin e Sportit, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, anëtar;
- b) Sekretarin e Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Shqiptar anëtar;
- c) Dy gazetarë sportivë (një me aftësi të kufizuara) anëtarë;
- ç) Një jurist (me kontribut në legjislationin për sportin) anëtar;
- d) Nëntë personalitete sportive nga disiplina të ndryshme të sportit anëtarë;
- dh) Një specialist nga Drejtoria e Sportit, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, sekretar.

2. Përbërja nominative e Këshillit Kombëtar të Sportit caktohet me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe këshilli thirret si rregull prej tij jo më shumë se 3 (tri) herë në vit.

3. Ministri i Arsimit dhe Sportit miraton rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Sportit.

4. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Sportit përfitojnë për pjesëmarrje në çdo mbledhje një shpërblim prej 5 000 (pesë mijë) lekësh. Pagesat për shpërblimet përballohen nga "Programi i sportit", në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

5. Vendimi nr. 88, datë 15.2.2006, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e përbërjes strukturore dhe shpërblimin e Këshillit Kombëtar të Sportit", i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

2014/3

VENDIM

Nr. 470, datë 9.7.2014

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR FINANCIMIN E FEDERATËS SHQIPTARE TË PESHËNGRITJES PËR PËRGATITJEN DHE PJESËMARRJEN E EKIPIT KOMBËTAR NË KAMPIONATIN BOTËROR TË PESHËNGRITJES, NË DATAT 4 - 16 NËNTOR 2014, NË KAZAKISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 10/1 të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005, "Për sportin", të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 183/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e Federatës Shqiptare të Peshëngritjes, në masën 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për të bërë të mundur përgatitjen dhe pjesëmarrjen në Kampionatin Botëror të Peshëngritjes, që do të zhvillohet në periudhën 4 - 16 nëntor 2014, në Kazakistan.
2. Fondet e destinuara për financimin e aktivitetit të akordohen në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si transfertë e pakushtëzuar, në llogarinë ekonomike 604, programi buxhetor 08140 "Programi për sportin".
3. Efektet financiare për financimin e aktivitetit të mbulohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Federata Shqiptare e Peshëngritjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

2015/1

VENDIM

Nr. 732, datë 2.9.2015

PËR BASHKËFINANCIMIN E STADIUMIT "LORO BORIÇI", SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005, "Për sportin", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi në dispozicion të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në masën 1 500 000 000 (një miliard e pesëqind milionë) lekë, në llogarinë ekonomike 604, programi buxhetor 08140 "Programi për sportin", të përdoret për bashkëfinancimin e projektit të stadiumit "Loro Boriçi", Shkodër.

2. Fondi të transferohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te bashkëfinancuesi, Federata Shqiptare e Futbollit, si transfertë, pas miratimit edhe nga Komiteti i Ndihmës Shtetërore, pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në llogari të Federatës Shqiptare të Futbollit, në bankë të nivelit të dytë.

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit të monitorojë mbarëvajtjen e punimeve në këtë objekt, nëpërmjet një grupi ekspertësh, me përfaqësues edhe nga Ministria e Zhvillimit Urban, Bashkia Shkodër,

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Federata Shqiptare e Futbollit dhe kompania projektuese.

4. Përbërja dhe detyrat e grupit të ekspertëve, si dhe procedura për transferimin e fondeve e transferimin kapital nga Federata Shqiptare e Futbollit te pronari i objektit, Bashkia Shkodër, të përcaktohen me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Bashkia Shkodër, Federata Shqiptare e Futbollit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama